



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 42/2011
Prishtinë, më 09. 12. 2011, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha - Shala, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi, dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Douglas Cruicshank dhe Berta Gajtani - USAID/BEEP, Nehat Dervishi – OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe konsulentja e Komisionit - Brikena Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 25 dhe 29. 11. 2011;
3. Miratimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - Kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të jetë vetëm një njoftim për procedimin e Raportit të Projektligjit nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 25 dhe 29. 11. 2011

Procesverbalet e mbledhjeve të datave 25 dhe 29. 11. 2011 u miratuan pa vërejtje.

3. Njoftim për Raportin me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari - Tha se Raporti me amendamente për Projektligjin nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve është miratuar nga komisionet kryesore. Ne, si komision, patëm marrë një vendim, që kur të mos ketë vërejtje, raporti të dërgohet për shqyrtim në seancë. Mirëpo më është kërkuar nga sekretaria e Komisionit që t'ju njoftoj lidhur me amendamentin 15, që e rregullon nenin 7 të Projektligjit, ku për shkak të disa problemeve tekniko-gjuhësore duhet të njoftohet Komisioni, sepse është bërë një ndërhyrje teknike me qëllim të rregullimit të atij neni, pra më një përmirësim teknik.

Deputetët u pajtuan me këtë përmirësim tekniko-gjuhësor lidhur me amendamentin 15, që e rregullon nenin 7 të Projektligjit.

4. Të ndryshme

Kryetari – I njoftoi deputetët se më 12 dhjetor 2011, në mbështetje të Projektit të USAID-BEEP, do të organizohet një tryezë e rrumbullakët me temë: “Legjislacioni për tregtinë, që më së miri lehtëson tregtinë dhe nxit prodhimin e brendshëm”. Ai kërkoj nga deputetët të jenë të pranishëm dhe t'i ftojnë të marrin pjesë edhe deputetët e tjerë, të interesuar, nga grupet e tyre parlamentare.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit